

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË**, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Lumni Sallauka, kryetar i kolegjit, Frosina Sylejmani dhe Burim Shala, anëtar të kolegjit, në çështjen juridike kontestimore të paditësit-kundërpaditurit M.E. nga Prizreni, Rr.”...” p.n, të cilin me autorizim e përfaqëson av. A.J. nga Prizreni, kundër të paditurit-kundërpaditësit Q.M. nga Prizreni, Rr.”...” nr..., me objekt të padisë dorëzimin e paluajtshmërisë dhe objekt të kundërpadisë vërtetimin e të drejtës së pronësisë, vlera e kontestit 3.100 euro, duke vendosur sipas ankesës së të paditësit-kundërpaditurit, e paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prizren C.nr.699/11, i datës 30.10.2012, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 20.04.2018, mori këtë:

## **A K T V E N D I M**

**APROVOHET** si e themeltë ankesa e paditësit-kundërpaditurit M.E. nga Prizreni, **PRISHET** aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prizren C.nr.699/11, i datës 30.10.2012 dhe lënda i kthehet të njëjtës gjykatë në rishqyrtim dhe vendosje.

## **A r s y e t i m**

Gjykata e shkallës së parë, me aktgjykimin e atakuar C.nr.699/11, i datës 30.10.2012, në pikën I të dispozitivit e ka refuzuar kërkesëpadinë e paditësit-kundërpaditurit si të pabazuar, me të cilën kanë kërkuar që “të detyrohet i padituri-kundërpaditësi Q.M. nga Prizreni që t’ia dorëzojë paditësit-kundërpaditurit në shfrytëzim të lirë dhe disponim sipërfaqen prej 4 ari, e cila është pjesë e njësisë kadastrale P-71813068-05706-1 dhe të detyrohet i padituri-kundërpaditësi që t’ia paguajë shumën prej 800 euro, të cilën e ka paguar paditësi-kundërpaditurit në emër të rrymës, ujit dhe rrugës, në afat prej 15 ditësh pas plotëfuqishmërisë së aktgjykimit”. Në pikën II të dispozitivit e ka aprovuar si të bazuar kërkesën nga kundërpadia e të paditurit-kundërpaditësit Q.M. nga Prizreni dhe ka “vërtetuar se ai është pronar i paluajtshmërisë e cila evidentohet si njësi kadastrale P-71813068-05706-1, në tërë sipërfaqen prej 1067 m2, në vendin e quajtur “Atmejdan”, fletëposedimi nr.11408 ZK Prizren, që paditësi-kundërpadituri obligohet ta pranojë dhe të lejojë që i padituri-kundërpaditësi të regjistrohet si pronar i të njëjtës paluajtshmëri në Drejtorinë për gjeodezi dhe kadastër, në afat prej 15 ditësh pas plotëfuqishmërisë së aktgjykimit, nën kërcënim të përmbarimit të dhunshëm, kjo pas pagesës paraprake të shumës së mbetur të çmimit të shitëblerjes nga pika e mëposhtme”. Në pikën III të dispozitivit ka vendosur ta obligojë të paditurin-kundërpaditësin që t’ia paguajë paditësit-kundërpaditurit shumën prej 21.000 DM, në kundërvlerën e këmbyer në Euro në ditën e pagimit, sipas kursit zyrtar, në të cilën shumë do të llogaritet kamata ligjore me fillim prej datës 01.04.2002, deri në pagesën definitive, e të gjitha në afat prej 15 ditësh pas plotëfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarimit të dhunshëm”. Në pikën IV të dispozitivit ka vendosur që masa e sigurisë e propozuar nga paditësi-kundërpaditësi, është tërhequr. Në pikën V të dispozitivit të aktgjykimit ka vendosur që secila palë ti bartë shpenzimet e veta procedurale.

Kundër këtij aktgjykimi paditësi-kundërpadituri përmes të autorizuarit të tij, në afat ligjor kanë paraqitur ankesë duke e atakuar aktgjykimin e goditur për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore, konstatimit të gabuar dhe jo të lotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që të prishet aktgjykimi i atakuar dhe lënda t’i kthehet gjykatës së shkallës së parë në rishqyrtim dhe vendosje, ose të aprovohet ankesa e paditësit-kundërpaditurit, të ndryshohet aktgjykimi i

atakuar, të aprovohet kërkesëpadia e paditësit-kundërpaditurit dhe të refuzohet kërkesa nga kundërpadia e të paditurit-kundërpaditësit.

Përgjigje në ankesë ka parashtruar pala e paditur-kundërpaditëse, përmes së cilës i ka propozuar gjykatës së shkallës së dytë që të refuzohet si e pabazuar ankesa e paditësit-kundërpaditurit dhe aktgjykimi i atakuar të vërtetohet në tërësi.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktgjykimin e atakuar, në mbështetje të dispozitës së nenit 194 dhe 195, të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), ka gjetur se:

**-Ankesat e paditësit-kundërpaditurit është e bazuar.**

Nga shkresat e lëndës rezulton se me datë 07.10.2011, asokohe në Gjykatën Komunale në Prizren, paditësi-kundërpadituri M.E. nga Prizreni, përmes të autorizuarit të tij ka paraqitur padi, kundër të paditurit-kundërpaditësit Q.M., me të cilën ka kërkuar që “të detyrohet i padituri-kundërpaditësi Q.M. nga Prizreni që t’ia dorëzojë paditësit-kundërpaditurit në shfrytëzim të lirë dhe disponim sipërfaqen prej 4 ari, e cila është pjesë e njësisë kadastrale P-71813068-05706-1 dhe të detyrohet i padituri-kundërpaditësi që t’ia paguajë shumën prej 800 euro, të cilën e ka paguar paditësi-kundërpaditurit në emër të rrymës, ujit dhe rrugës, në afat prej 15 ditësh pas plotëfuqishmërisë së aktgjykimit”.

Ndërsa në të njëjtën gjykatë i padituri-kundërpaditësi Q.M. nga Prizreni, përmes të autorizuarës së saj, me datë 16.12.2009, ka parashtruar padi kundër paditësit-kundërpaditurit M.E., me të cilën ka kërkuar që “të vërtetohet se ai është pronar i paluajtshmërisë e cila evidentohet si njësi kadastrale P-71813068-05706-1, në tërë sipërfaqen prej 1067 m<sup>2</sup>, në vendin e quajtur “Atmejdan”, fletëposedimi nr.11408 ZK Prizren, që paditësi-kundërpadituri obligohet ta pranojë dhe të lejojë që i padituri-kundërpaditësi të regjistrohet si pronar i të njëjtës paluajtshmëri në Drejtorinë për gjeodezi dhe kadastër, në afat prej 15 ditësh pas plotëfuqishmërisë së aktgjykimit, nën kërcënim të përmbarimit të dhunshëm”. Kjo lëndë është evidentuar në gjykatë me nr. C.nr.982/09.

Gjykata e shkallës së parë, fillimisht me aktvendimin C.nr.699/11, i marr në procesverbalin e shqyrtimit kryesor të datës 11.09.2012, ka vendosur që të bashkojë lëndët C.nr.699/11 dhe C.nr.982/09, pasi ka konsideruar se në rastin konkret kemi të bëjmë me palë të njëjta dhe me kërkesa që ndërlidhet me njëra tjetrën. Më pas, duke vepruar sipas padisë së paditësit-kundërpaditurit dhe kërkesës nga kundërpadia e të paditurit-kundërpaditësit, gjykata e shkallës së parë ka mbajtur shqyrtimin kryesor dhe ka administruar provat e paraqitura nga palët ndërgjyqëse si: kontratën mbi shitëblerjen e paluajtshmërisë (dhuratën), të datës 12.11.2001, e lidhur në mes M.L., M.P., N.P., V.P., , si shitës dhe Q.M. si blerës, certifikatën mbi të drejtën e pronësisë P-71813068-05706-1, të datës 14.09.2011, kopjen e planit për parc. kad. Nr.5706/1, fletëposedimin nr.11408, datë 14.07.2005, ka dëgjuar dëshmitarët H.L., I.C., B.P., S.E., B.M., N.SH., M.P, DHE R.H., ka bërë shikimin në shkresat e lëndës civile C.nr.755/09 dhe ka dëgjuar në cilësi të palës palët ndërgjyqëse, si dhe pas vlerësimit të këtyre provave ka nxjerrë aktgjykimin e atakuar C.nr.554/06, i datës 17.09.2012, me të cilën e ka në tërësi kërkesëpadinë e paditësve dhe kërkesën e ndërhyrësës si të pabazuar, duke vendosur si në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar C.nr.699/11, i datës 30.10.2012.

Pikëpamjet juridike të gjykatës së shkallës së parë, kjo gjykatë nuk mund t’i pranon si të rregullta dhe të ligjshme, për arsye se aktgjykimi i atakuar është përfshirë me të meta thelbësore nga neni 182.2 pika o), lidhur me nenin 2 parag.1 të LPK-së dhe nga neni 182.2 pika n) të LPK-së, pasi që me rastin e vendosjes gjykata e shkallës së parë pa pasur kërkesë të palës paditëse-

kundërpaditur ka vendosur si në pikën III të dispozitivit të aktgjykimit të atakuar, për çka në rastin konkret është tejkaluar kërkesëpadia, si dhe aktgjykimi i ankimuar ka të meta për shkak të cilave nuk mund të ekzaminohet, dispozitivi i aktgjykimit është i pa kuptueshëm dhe kontradiktor me vetveten dhe me arsyetimin e aktgjykimit. Gjithashtu arsyetimi i aktgjykimit është i pa argumentuar për faktet vendimtare, faktet vendimtare janë kundërthënëse midis asaj që në arsyet e aktgjykimit dhe përmbajtjes së provave materiale të cilat gjenden në shkresat e lëndës.

Duke e shqyrtuar aktgjykimin në kufijtë e pretendimeve ankimore, Gjykatës së Apelit i ka rezultuar si i bazuar pretendimi ankimor i palës paditëse-kundërpaditur i cekur në ankesë se aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë është nxjerrë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, pasi që në rastin konkret gjykata e shkallës së parë pa kërkesë të palës paditëse-kundërpaditur ka vendosur sikurse pikën III të dispozitivit të aktgjykimit të atakuar. Nëse i referohemi përmbajtjes së padisë dhe kërkesëpadisë së paditësit-kundërpaditurit, rezulton se e vetmja kërkesë e tij ka qenë obligimi i të paditurit-kundërpaditësit për t'ia dorëzuar në posedim dhe shfrytëzim të lirë 4 ari nga pjesa e ngastrës kontestuese, e jo kërkesa që të obligohet ky i fundit që t'ia paguajë shumën e cekur në pikën III të dispozitivit të aktgjykimit të atakuar. Gjithashtu nëse i referohemi shkresave të lëndës dhe procesverbaleve të shqyrtimit kryesor, nuk rezulton se pala paditëse-kundërpaditur të ketë bërë ndonjë precizim të kërkesëpadisë apo zgjerim të saj edhe me ndonjë kërkesë tjetër në raport me palën e paditur-kundërpaditëse. Nga kjo rezulton se gjykata e shkallës së parë me rastin e vendosjes ka bërë shkelje të nenit 182.2 pika o), lidhur me nenin 2 parag.1 të LPK-së, përkatësisht ka bërë tejkalim të kërkesëpadisë së paditësit-kundërpaditurit, duke e shkelur edhe parimin e disponibilitetit të palëve, i përcaktuar shprehimisht në nenin 2 parag. 1 të LPK-së, i cili shprehimisht thotë se *“Në procedurë kontestimore gjykata vendos brenda kufijve të kërkesave që janë parashtruar nga palët ndërgjyqëse”*. Ndërsa esenca e parimit të disponibilitetit në vetvete përmban tri elemente bazë dhe atë: a) nëse do të fillojë një procedurë kontestimore ose jo, varet ekskluzivisht nga vullneti i palëve, b), palët në procedurë përcaktojnë se për çka do të procedohet, si dhe c), faktin se palët mund të vendosin vetë se kur do të përfundojë procesi gjyqësor civil. Përveç shkeljeve të sipërcituarra, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës gjykatës së shkallës së dytë i ka rezultuar se kemi mos përputhje në mes aktgjykimit burimor (dispozitivit të aktgjykimit), i cili i është bashkangjitur procesverbalit të fundit të shqyrtimit kryesor të datës 30.10.2012 dhe atgjykimit të cilin gjykata e shkallës së parë ia ka ekspeduar palëve ndërgjyqëse. Kjo për faktin se aktgjykimi burimor siç është cekur më lartë nuk e përmban fare pikën III të dispozitivit të aktgjykimit të dorëzuar palëve, e që ka të bëjë me detyrimin e të paditurit-kundërpaditësit që të paguajë shumën prej 21.000 DM, në emër të çmimit të papaguar për shitëblerjen e ngastrës kontestuese. Edhe kjo në vetëvehte përmban shkelje të dispozitave të procedurës kontestimore, pasi që në secilin rast duhet të ketë përputhje në mes aktgjykimit burimor dhe atij që i dorëzohet palëve ndërgjyqëse.

Gjithashtu, Gjykatës së Apelit i ka rezultuar si i bazuar pretendimi ankimor i palës paditëse i cekur në ankesë se aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë është nxjerrë duke e vërtetuar në mënyrë të gabuar dhe jo të plotë gjendjen faktike, si rezultat i së cilës edhe është zbatuar gabimisht e drejta materiale. Përkundër faktit se pala paditëse-kundërpaditur në padi i ka propozuar gjykatës që të bëjë këqyrjen në vend së bashku me ekspertin e gjeodezisë për të vërtetuar në mënyrë të drejtë dhe të plotë gjendjen faktike, gjykata e shkallës së parë nuk ka bërë një gjë të tillë, por është mjaftuar me shikimin në shkresat e lëndës C.nr.755/09, në të cilën ekzistojnë ekspertizat përkatëse, por të cilat janë kryer për nevoja të asaj procedure që për objekt ka pasur pengim posedimin. Duke marr parasysh natyrën e kontesteve të pengim posedimit (në të cilat nuk shqyrtohet çështja e pronësisë, por vetëm posedimi), atëherë gjykata e

shkallës së parë nuk është dashur që aktgjykimin e saj ta bazojë pikërisht në këto ekspertiza, por të bëjë vet këqyrjen në vend së bashku me ekspertin e fushës përkatëse. Në anën tjetër, është obligim ligjor i gjykatës së shkallës së parë, që rrjedhë nga neni 326 parag. 1 dhe 2, lidhur me nenin 356 të LPK-së, që kur kërkohet nga pala, të bëjë të provuarit përmes ekspertizës, sa herë që për vërtetimin e fakteve, apo rrethanave të caktuara nevojitet dijeni profesionale të cilën nuk e ka gjyqtari i çështjes.

Si rrjedhojë, për shkak të mangësive të evidentuara më lartë, e që i referohen shkeljeve thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, si dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, gjykata e shkallës së dytë ka vlerësuar se nuk janë krijuar kushtet ligjore që të mund të ndryshohet aktgjykimin i gjykatës së shkallës së parë, por është dashur që të priset aktgjykimin i atakuar dhe lënda të rikthehet në rigjykim dhe vendosje.

Andaj, udhëzohet gjykata e shkallës së parë që në ri procedurë të veprojë sipas vërejtjeve të gjykatës së shkallës së dytë, t'i eliminojë shkeljet e sipër theksuara, ndërsa me rastin e vendosjes të merr për bazë vetëm kërkesëpadinë e palës paditëse-kundërpaditur dhe kërkesën nga kundërpadia, të bëjë këqyrjen në vend së bashku me ekspertin e gjeodezisë, nga i cili më pas të kërkojë raport të detajuar mbi të gjeturat në vend dhe në elaboratin kadastral për ngastrën kontestuese, ndërsa pas administrimit të provave të propozuara nga palët ndërgjyqëse të zbatojë me përpikmëri nenin 8, lidhur me nenin 160 parag.4 të LPK-së, përkatësisht në arsyetimin e aktgjykimin të jap të gjitha vlerësimet e nevojshme për secilën provë të administruar, cilat fakte vendimtare i ka vërtetuar me provat e administruara dhe pas vërtetimit të gjendjes faktike, të vendos për kërkesëpadinë e paditësit-kundërpaditurit dhe kërkesën nga kundërpadia të paditurit-kundërpaditësit në bazë të ligjit.

Nga të cekurat me lartë, e në mbështetje të dispozitave nga neni 194, dhe 195 parag.1 pika (c) e LPK-së, Gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË**  
**Ac.nr.2002/2013, datë 20.04.2018**

**Kryetari i kolegjit,  
Lumni Sallauka, d.v**